



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 4.02.2021

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

MBI

**DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 11915 DATË 14.01.2021 PËR
KTHIMIN E LIGJIT NR. 168/2020 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9981,
DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË
NDRYSHUAR”**

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 4.02.2021, shqyrtoi Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 11915, datë 14.01.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat caktoi relator për shqyrtimin e këtij dekreti, Z. Rolant Xhelilaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm:

Nga Presidenca: Z. Petraq Milo, Keshilltar i Presidentit për Ekonominë; dhe Z. Bledar Dervishaj, Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Znj. Vasilika Vjerro, Zv. Ministër

II. Baza ligjore dhe aspekti procedural:

Presidenti i Republikës bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka depozituar pranë Kuvendit, Dekretin nr. 11915, datë 14.01.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

Bazuar në nenin 86, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret, është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, me cilësinë e komisionin përgjegjës, bazuar në nenin 86, dhe 32-38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës, ndaj edhe shqyrtimi i tij do të fokusohet vetëm në këto çështje.

III. Pretendimet e Presidentit të Republikës

Presidenti i Republikës në arsyetimin e tij për kthimin e ligjit në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar si më poshtë vijon:

Ligji nr. 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”, paraqet këto problematika:

- Zgjeron në mënyrë të pa argumentuar qartë dhe jo koherente përjashtimet nga zbatimi i regjimit ligjor fiskal, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e vetë ligjit bazë nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, i ndryshuar;
- Shton precedentët për një efekt të mëtejshëm zinxhir në shtimin e kërkesave të paargumentuara për uljen e nivelit të tarifës doganore, pa një planifikim dhe analizë konkrete financiare;
- Zgjerimi i rrethit të përjashtimeve të kësaj natyre ndikon potencialisht në uljen e të ardhurave doganore nga tarifatat doganore, në mënyrë të pakontrolluar, pa analizuar pasojat që do të vijojnë nga ndryshime të tilla të shpeshta dhe të shkëputura.
- Krijon një diferencim të trajtimit të mallrave të tjera, që i nënshtrohen niveleve të tarifës doganore;
- Krijon idenë e një favorizimi me natyrë klienteliste dhe preferenciale, sepse favorizon mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte që përdoren për qëllim kënaqësie dhe argëtimi, ndërkohë që ekonomia e vendit po përballlet me një situatë shumë të vështirë

ekonomike që kërkon një plan tërësor masash, për përballimin e efekteve të shkaktuara nga pandemia e Covid-19,

- Nuk është në harmoni me nevojat emergjente të vendit, si dhe me parashikimet e Institucioneve Financiare, të cilat raportojnë për përkeqësimin e situatës ekonomike në vendin tonë.
- Referuar kohës së depozitimit të kësaj nisme në datë 3.11.2020 kur Shqipëria ishte në një situatë epidemike të rënduar dhe me numër shumë të lartë të rasteve të përhapjes së infeksionit Covid-19, apo dhe kohës së miratimit të këtij ligji në datë 30.12.2020, tregon qartë se veprimtaria legjislative e Kuvendit të Shqipërisë nuk është e orientuar drejt nevojave bazike të shtresave më në nevojë të shoqërisë, por për plotësimin e kërkesave të shumë pak individëve që të shtojnë në inventarët e tyre individualë apo të biznesit, mjete të lundrimit të luksit për argëtim.

IV. Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit në komision.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat përmes relatorit, bëri një analizë të detajuar të dekretit të Presidentit në gjithë elementët e tij, duke vlerësuar se asnjë prej këtyre pretendimeve nuk janë të argumentuara dhe të bazuara.

Përpara analizimit të argumenteve të Presidentit u evidentuan se, kompetencat e Presidentit të Republikës përcaktohen ndër të tjera në nenet 85 dhe 92 të Kushtetutës.

Neni 94 i Kushtetutës thekson se “Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”.

Nga shqyrtimi i Dekretit të Presidentit rezulton se në asnjë element të tij, nuk është evidentuar mospërputhje të ligjit nr. 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”, me dispozitat Kushtetuese, çfarë përbën edhe qëllimin e së drejtës së Presidentit për kthimin e ligjit për rishikim, bazuar në nenin 85 të Kushtetutës.

Pra ligji nr. 168/2020, nuk cenon asnjë nga parimet kushtetuese të lidhura me kufizimin e të drejtave dhe lirive për gëzimin lirisht të pronës, lirinë e veprimtarisë ekonomike, barazinë përpara ligjit, mos diskriminimin e operatorëve në treg, lirinë kontraktuale, sigurinë juridike etj., pasi në fakt ligji nr. 168/2020, nuk kufizon apo shton barrën fiskale por përkundrazi, ka mundësuar një lehtësi tjetër fiskale në kuadër të një sërë iniciativash të tjera të Qeverisë për stimulimin e turizmit në vend, një sektor ky me një rëndësi të veçantë për vendin, e që lidhet njëkohësisht, me një tërësi përfitimesh e përfituesish siç do të evidentojmë edhe më poshtë, e që për këtë qëllim, përbën një nismë me interes publik.

Për sa më sipër elementi më i rëndësishëm që duhet evidentuar është që ligji nr. 168/2020, është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, Kushtetuta përcakton se “politikat shtetërore ekonomike, sociale, mjedisore etj., janë atribut i Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Kjo kompetencë del akoma më e qartë po t’i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, vendimin nr. 15/2010, të kësaj Gjykate ku përcaktohet se:

“Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkalar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta, brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.”.

Për sa më sipër, është detyrë dhe kompetencë ekskluzive e Këshillit të Ministrave që, në kuadër të ruajtjes së stabilitetit ekonomiko-financiar të vendit dhe të qëndrueshmërisë së buxhetit të shtetit, të hartojë politika ekonomike e sociale, bazuar në programin e tij ekonomik, në prioritetet strategjike dhe në zhvillimet ekonomike kombëtare e ndërkombëtare, duke synuar mbrojtjen e interesit publik.

Ligji 168/2020, është vërtetë iniciativë e një deputeti, por në respektim të nenit 82 të Kushtetutës, ka marrë dakortësinë e Qeverisë përmes vendimit nr. 1039, datë 16.12.2020 “Për dhënien e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”, çfarë do të thotë se është në harmoni me politikat ekonomike e sociale, programin ekonomik, me prioritetet strategjike dhe në zhvillimet ekonomike kombëtare.

- 1. Lidhur me pretendimet se duke zgjeruar përjashtimet nga zbatimi i regjimit ligjor fiskal, rrezikon qëndrueshmërinë e vetë ligjit bazë nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar dhe shton precedentët për një efekt të mëtejshëm zinxhir në shtimin e kërkesave të paargumentuara për uljen e nivelit të tarifës doganore pa analizë konkrete financiare komisioni vlerësoi se:***

Tarifa Doganore e Republikës së Shqipërisë përfshin, Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, e cila bazohet në Sistemin e Harmonizuar (Konventa Harmonized System), çdo nomenklaturë tjetër, të bazuar tërësisht apo pjesërisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave; nivelet e detyrimeve doganore ose autonome normale, që zbatohen për mallrat e përfshira në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave; masat tarifore preferenciale, të përcaktuara në marrëveshjet që Republika e Shqipërisë ka lidhur me një vend ose territor të

caktuar jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose grup-vendeve apo territoreve; masat tarifore preferenciale; trajtimin tarifor favorizues të specifikuar për mallra të caktuara, për shkak të natyrës apo përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar (end-use), si dhe masa të tjera tarifore, të parashikuara nga legjislacioni bujqësor apo tregtar, ose çdo legjislacion tjetër i Republikës së Shqipërisë.

Miratimi i niveleve tarifore bëhet me ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar i cili bazohet në rregullat e taksimit të përcaktuara në ligjin nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e kombinuar të mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar.

Duhet theksuar se Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave, përbëhet nga 99 kapituj dhe përmban më mijëra kode tarifore (çdo mall që ekziston në planet ka një kod tarifor respektiv), të cilat janë objekt i vazhdueshëm rishikimi me qëllim ofrimin gjithnjë e më shumë të lehtësirave dhe heqjen e barrierave në tregtinë midis vendeve.

Aktualisht, Shqipëria aplikon 5 nivele të tarifës doganore atë zero % (pa taksë), 2%, 5%, 10% dhe 15%. Një numër tejet i madh kodesh tarifore janë në tarifën zero %, apo 2%, për shkak të politikave fiskale brenda vendit si dhe në kuadër të një sërë marrëveshjes së tregtisë së lirë si ajo me BE (MSA) me CEFTA, EFTA etj., marrëveshje këto që synojnë lehtësimin e tregtisë dhe lëvizjes së lirë të mallrave.

Parë në këtë kontekst, ulja e nivelit tarifor të 2 kodeve tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të mallrave, respektivisht kodi NKM 8903 10 10 dhe kodi NKM 8903 10 90, nuk ka asnjë mundësi teorike dhe praktike të ndikojnë në rrezikimin e qëndrueshmërisë së ligjit bazë nr. 9981, datë 8.9.2008.

Bazuar në nivelin e tarifave doganore aktuale dhe Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, konstatojmë se pothuajse të gjithë mallrat e përfshira në kapitullin 89 “anijet, varkat dhe strukturat lundruese”, janë me tarifë doganore 2%. Këtu përfshihen “varkat me vela, me ose pa motor ndihmës”, “Varkat me motor, të ndryshme nga varkat me motor jashtë bordit” etj.

Ndërkohë po në këtë kapitull, kodi tarifor (6 shifror) të NKM 8903 10, ku përfshihen “mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz”, kod ky i përfshin në vetvete 2 kode (tetë shifrore) respektivisht kodi NKM 8903 10 10 “Me peshë jo më shumë se 100 kg secila” dhe kodi NKM 8903 10 90 “Të tjera” ka tarifë doganore 15%. Ky fakt i vendos këto mjete ujore me tarifë doganore 15%, në pozita të pabarabarta dhe të disfavorshme përkundrejt mjeteve të tjera ujore me tarifë doganore 2%, ndaj një prej qëllimeve të kësaj nisme është unifikimi i tarifës doganore për mjetet lundruese në fushën e turizmit detar.

Ulja e nivelit tarifor për këto 2 kode të NKM paraqet një interes të përgjithshëm dhe ka për qëllim stimulimin e shtimin e mjeteve ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz

dhe zhvillimin e turizmit detar, nxitjen e diversifikimit të turizmit, në mënyrë që të sigurohet një turizëm më i qëndrueshëm dhe gjithëvjeter.

Në dekret nuk ka asnjë argument se përse ulja e nivelit tarifor të këtyre dy kodeve do ta rrezikojë qëndrueshmërinë e vetë ligjit bazë. Siç theksova edhe më lart, ligji bazë ka me qindra kode me nivel zero % apo 2% të tarifës dhe në këto kushte, nuk bën asnjë sense logjik por edhe praktik pretendimi për rrezik qëndrueshmërie të ligjit dhe se aplikimi i këtij përjashtimi do të krijojë një precedent për një efekt të mëtejshëm zinxhir në shtimin e kërkesave të paargumentuara për aplikimin e këtij rregulli përjashtues, është tërësisht jo i bazuar.

Theksoj se kjo iniciative ka ardhur në vazhden e shumë iniciativave të tjera të miratuara tashmë nga Kuvendi me fokus stimulimin e turizmit në sektorë apo nën sektorë të ndryshëm, të tilla si:

- Miratimi i ligjit nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave, kushteve dhe kriterëve për aktivitetet e turizmit detar, të mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim, infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e tyre dhe përcaktimin e përgjegjësive institucionale në fushën e turizmit, duke krijuar kështu një kuadër ligjor koherent për turizmin e detit.
- Përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në import, të jahteve dhe mjeteve të tjera ujore, që përdoren për qëllime turistike, kënaqësie dhe argëtimi, jo më të vjetra se 20 vjet
- Uljen e tatimit fitimit në 0 % për 10 vitet e para fiskale, përstrukturat akomoduese “Hotelet/resortet me katër dhe pesë yje, status special”, mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht.
- Aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së në 6 për qind, për çdo furnizim shërbimi të ofruar brenda strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, si dhe për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit.
- Zhvillimin e sektorëve të veçantë të turizmit, siç është dhe agroturizmi për të cilën është propozuar aplikimi i një norme të reduktuar të tatimit fitimit në masën 5 %, për një periudhë 10 vjeçare.
- Përjashtimin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe e investimeve në infrastrukturë për strukturat akomoduese të çertifikuara si agroturizëm; etj.

Gjithashtu krijimi i një kuadri rregullator në favor të tërheqjes së mjeteve lundruese turistike dhe zhvillimit të sektorit të turizmit detar është parashikuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023, miratuar me vendim nr.413, datë 19.6.2019, të Këshillit të Ministrave.

2. Lidhur me pretendimet se zgjerimi i rrethit të përjashtimeve të kësaj natyre ndikon

potencialisht në uljen e të ardhurave doganore nga tarifatat doganore, në mënyrë të pakontrolluar, pa analizuar pasojat që do të vijojnë nga ndryshime të tilla të shpeshta dhe të shkëputura dhe se krijon një diferencim të trajtimit e mallrave të tjera, që i nënshtrohen niveleve të tarifës doganore, komisioni vlerësoi se:

Së pari ka një lapsus në këtë konkluzion të Presidentit, pasi ligji 168/2020, nuk përban përjashtim nga tarifa doganore, por mundëson një reduktim të tarifës doganore nga 15% në 2%.

Ligji 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar,” ka për qëllim, të krijojë një lehtësi tjetër fiskale në fushën e turizmit detar, e cila favorizon dhe stimulon shtimin e një kategorie specifike të mjeteve lundruese turistike, të cilat për shkak të natyrës dhe kostos së tyre janë më të pëlqyeshme dhe më të aksesueshme për individët.

Referuar elementit “kosto”, evidentojmë se kostoja e mjeteve të lundrimit me fryrje (varkat e gomës apo gomonet etj.), është shumë herë më e ulët se ajo e një jahti, çfarë i bën këto mjete ujore më të aksesueshme nga një masë më e gjerë e popullatës dhe për rrjedhojë edhe më të preferuara. Në këto kushte, ulja e tarifës doganore për këto mjete, do të mundësojë shtim të kërkesës për importim të tyre dhe për rrjedhojë shtim të përdorimit të tyre nga qytetarët apo bizneset specifike, duke krijuara kështu një klimë akoma më të favorshme drejt stimulimit dhe promovimit të turizmit, duke e bërë atë më atraktiv dhe të konkurrencë në kompleksitetin e tij.

Për 3 vitet e fundit, për këto 2 kode tarifore 8 shifrore të përfshirë në kodin tarifor NKM 8903 10 si më poshtë:

- Për vitin 2018, janë importuar gjithsej 2 517 mjete ujore, me vlerë detyrimi doganor 2 724 375 lekë dhe TVSH në masën 5 140 623 lekë.
- Për vitin 2019, në të dy këto kode tarifore, janë importuar gjithsej 551 mjete ujore, me vlerë detyrimi doganor 3 956 050 lekë dhe TVSH në masën 6 745 906 lekë.
- Për vitin 2020, në të dy këto kode tarifore, janë importuar gjithsej 1493 mjete ujore, me vlerë detyrimi doganor 2 981 224 lekë dhe TVSH në masën 8 389 103 lekë.

Nga analizimi i këtij trendi, vlerësohet se edhe efekti në të ardhura të jete rreth 2 400 000 lekë në taksë doganore (një vlerë kjo jo e konsiderueshme për Buxhetin e Shtetit) por që në rast të shtimit të numrit të importeve, do të influencojë në rritjen e të ardhurave nga TVSH duke bërë kështu edhe balancimin e kësaj direference.

Për gjithë sa më sipër analizuar nuk mund të pretendohet se reduktimi i nivelit të tarifës doganore për këto 2 kode, do të ndikojë në këto të ardhura në sensin negativ dhe se as që do të bëjë diferencim mes mallrave të ndryshëm, pasi sic evidentuam, ligji 168/2020 synon

pikëtishtë të heqë diferencimin në trajtimin fiskal të këtyre dy kodeve aktualisht me tarifë 15%, duke u barazuar në nivel me shumicën e kodeve tarifor të kapitullit 89 të NKM.

- 3. Lidhur me pretendimet se ligji krijon idenë e një favorizimi me natyrë klienteliste dhe preferenciale, sepse favorizon mjetet e tjera ujore për kënaqësi dhe sporte që përdoren për qëllim kënaqësie dhe argëtimi, ndërkohë që ekonomia e vendit po përballet me një situatë shumë të vështirë ekonomike që kërkon një plan tërësor masash, për përballimin e efekteve të shkaktuara nga pandemia e Covid-19; nuk është në harmoni me nevojat emergjente të vendit, si dhe me parashikimet e Institucioneve Financiare, të cilat raportojnë për përkeqësimin e situatës ekonomike në vendin tonë dhe se referuar kohës së depozitimit të kësaj nisme, rezulton se Shqipëria ishte në një situatë epidemike të rënduar dhe me numër shumë të lartë të rasteve të përhapjes së infeksionit Covid-19, tregon qartë se veprimtaria legjislative e Kuvendit të Shqipërisë nuk është e orientuar drejt nevojave bazike të shtresave më në nevojë të shoqërisë, por për plotësimin e kërkesave të shumë pak individëve që të shtojnë në inventarët e tyre individualë apo të biznesit, mjete të lundrimit të luksit për argëtim, vlerësojmë si më poshtë vijon.***

Lidhur me këtë pretendim të Presidentit, së pari theksojmë se në situatën e pandemisë dhe tërmetit të 26 nëntorit 2019, sigurisht që prioriteti i Qeverisë dhe Kuvendit të Shqipërisë ishte dhe mbetet përballimi i pasojave të tërmetit dhe përballja me pandeminë Covid 19, por kjo nuk do të thotë që fokus i qeverisë duhet të ishte vetëm në këto dy sektorë, pasi diçka e tillë nuk do të ishte aspak e përshtatshme për vendin, për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit etj. Përkundrazi është detyrë e Qeverisë që të stimulojë politika të reja për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e sektorëve të ndryshëm në vend me qëllim daljen nga situata e vështirë

Si evidentuam edhe me lart vetëm për vitin 2020, nën këto dy kode tarifore janë importuar 1 493 mjete ujore. Dhe këto si nga individë ashtu dhe nga biznese, të cilët janë të shumtë në numër. Këto mjete ujore për kënaqësi dhe sporte, të fryra me ajër ose gaz, ndryshe nga jahtet, janë shumë herë më të lira duke i krijuar kështu mundësi shumë individëve për të patur akses tek to. Pretendimi për klientelizëm është tërësisht i pabazuar dhe nuk ka dhënë asnjë argument për ta justifikuar atë.

Në kushtet kur Presidenti iu referohet Institucioneve Financiare, e konsiderojmë me vënd që ti referohemi pikëtishtë vlerësimit nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Kështu sipas këtyre institucioneve ndërkombëtare, si Komisioni European, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikëqyrin ekonominë e vendit tonë, rezulton se: Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Këto institucione kanë theksuar se kufizimi i lëvizjeve dhe masat e distancimit social ndikuan në ecurinë e dy sektorëve kyç të ekonomisë, siç janë turizmi dhe industria prodhuese. Këta

sektorë po vuajnë më shumë pasojat e recesionit të Bashkimit Europian, që është njëherazi edhe partneri kryesor tregtar, i investimeve të huaja dhe i dërgesave të emigrantëve.

Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar pozitivisht politikat shtetërore në vendin tonë për zbutjen e efekteve të tërmetit të muajit nëntor 2019 dhe pandemisë shëndetësore COVID19. Ato kanë theksuar se menaxhimi i politikave ka qenë i përshtatshëm, janë krijuar kushtet financiare lehtësuese për qytetarët dhe bizneset dhe stabiliteti makroekonomik i vendit është ruajtur. Rritja e defiçitit fiskal, gjatë vitit 2020, është e përligjur, për të zbutur ndikimin e krizës.

Gjithashtu, këto institucione vlerësuan pozitivisht politikat për rritjen e pagave, rritjen e shpenzimeve sociale, shtyrjen e përkohshme të afateve të shlyerjes së huasë dhe ofrimin e garancisë sovrane të kredisë, për të lehtësuar biznesin në dhënien e pagave për punëmarrësit dhe për të ndikuar në rritjen e kapitalit qarkullues... Ekonomia shqiptare mund të rimëkëmbet vitin 2021, në rast se situata e pandemisë mbahet nën kontroll. Nxitje për rritjen ekonomike do të sjellin edhe procesi i rindërtimit, turizmi dhe ndërtimi. Këto institucione kanë dhënë edhe disa rekomandime për politikat buxhetore që duhet të ndiqen gjat vitit 2021 e më tej, kur pasojat e krizës të zbuten, për rimëkëmbjen ekonomike, rifillimin e konsolidimit fiskal dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.

Për sa më sipër, qartazi evidentohet se pretendimi i Presidentit nuk është relevant.

Gjithashtu do të donim të evidentonim edhe disa të dhëna lidhur me masat e marra nga Qeveria që janë mbështetur nga Kuvendi lidhur me përballimin e pandemisë Covid-189.

Kështu, buxheti për shëndetësinë në vitin 2021 është rritur në vlerë absolute me 4.2 miliardë lekë ose me rreth 7.3% krahasuar me planin e vitit 2021. Edhe nëse këtë krahasim do ta vendosnim në terma realë, rritja e buxhetit të Shëndetësisë në vitin 2021 është 0.3% e PBB.

Më tej, shpenzimet për Shëndetësinë gjatë vitit 2021 planifikohen në nivelin 3.7 % të PBB. Ky nivel është më i madhi i këtyre 30 viteve, pasi historiku i shpenzimeve për këtë sektor, sidomos deri në vitin 2013, maksimumin më të lartë e kanë pasur 2.7% të PBB.

Gjithashtu, qeveria ka parashikuar për vitin 2021 një sërë politikat mbështetëse për sektorin e shëndetësisë, si parashikimi i fondit prej 1.5 miliardë lekësh për vaksinën anti-COVID; rritja me 40 për qind e pagave për mjekët, infermierët dhe laborantët; parashikimi i fondit prej 1.2 miliardë lekësh, për paketën e rimbursimit të medikamenteve për kurimin nga pandemia Covid-19 etj.

Në dekretin e Presidentit duket sikur vlerësohet se pandemia COVID-19 do të persistojë në gjatë gjithë vitit 2021, ndërkohë që situata aktuale në botë është shumë shpresë dhënëse, pasi vaksinat kundër COVID-19 tashmë kanë filluar të shpërndahen dhe së shpejti pritet ardhja e dozave të vaksinave në vendin tonë për vaksinimin e trupësh mjeksore dhe më pas të individëve më vulnerable. Janë pikërisht këto zhvillime që kanë ndikuar dhe në parashikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021, ku një pjesë e

konsiderueshme e fondeve për luftën ndaj COVID-19 do të alokohen për blerjen e vaksinës kundër saj.

Së fundmi vlen të theksohet fakti se pandemia e shkaktuar nga COVID-19, ka vënë në vështirësi vendet e zhvilluara të Europës dhe të Amerikës Veriore që në fillimet e saj dhe, aktualisht, këto vende po hasin vështirësi të konsiderueshme në përballimin e flukseve të pacientëve të infektuar nga COVID-19 në strukturat shëndetësore, pavarësisht faktit se shpenzimet për sektorin e shëndetësisë në këto vende janë rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2020 dhe vitit të ardhshëm. Kjo do të thotë që rritja disproporcionale e shpenzimeve për sektorin e shëndetësisë, për përballimin e pandemisë COVID-19, nuk ka qënë çelësi i vetëm për përballimin me sukses të pandemisë në këto vende dhe sigurisht në vendin tonë. Masat e tjera të marra si: higjiena personale, mbajtja e maskave, kufizimet e lëvizjes së qytetarëve, kufizimet e bizneseve etj. kanë rezultuar njësoj efektive në mbajtjen e pandemisë COVID-19 në shifra të përballueshme për sistemet shëndetësore respektive.

Thënë këto, qartazi edhe këto prete dime të Presidentit nuk qëndrojnë.

V. Përfundime

Në përfundimit të shqyrtimit të Dekretit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, vlerësoi se ligji nr. 168/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar” është miratuar në përputhshmëri të plotë me parimet kushtetuese dhe me votat e pro të shumicës së anëtarëve të komisionit të pranishëm, vendosi rrëzimin e Dekretit nr. 11915, datë 14.01.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 168/2020 Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

RELATOR

Rolant XHELILAJ

KRYETAR

Anastas ANGJELI